



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1568/ 11 prot.

Datë 04/08/2025

V E N D I M

Nr. 1007/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04/08/2025, shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 917/2025, datë 16.07.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me numër reference Nr. REF-47417-05-09-2025, me objekt: “Rikonstruksioni i objektit nr.2, “godinë 3-katëshe”, në Repartin Ushtarak Nr.1010 Vau-Dejës, Shkodër”, me fond limit 35.605.664,51 leke pa TVSH zhvilluar me datë 27.05.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “NIKA” SHPK me NIPT J76705047U dhe me adresë: Lagjja “Vasil Shanto”, Bulevardi “Skenderbeu” Godinë 8-katëshe, Kati i I-rë, Zona kadastrale 8593, nr.pasurie 5/587” 4001, Shkodër.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A
Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021

“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 16.07.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 917/2025, ku vendosi:

- 1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “NIKA” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me numër reference Nr. REF-47417-05-09-2025, me objekt: “Rikonstruksioni i objektit nr.2, “godinë 3-katëshe”, në Repartin Ushtarak Nr.1010 Vau-Dejës, Shkodër”, me fond limit 35.605.664,51 leke pa TVSH zhvilluar me datë 27.05.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A.*
- 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “NIKA” SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.*
- 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera*
- 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “NIKA” SHPK.*
- 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*

*6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr. 1495/9 prot., datë 24.07.2025, protokolluar me tonën nr. 1568/8 prot, datë 25.07.2025, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A, lidhur me zbatimin e Vendimit Nr. 917/2025, datë 16.07.2025, njofton se ka zbatuar vendimin e sipërpërmendur, duke e kualifikuar ofertën e operatorit ekonomik “NIKA” ShPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me numër reference Nr. REF-47417-05-09-2025, me

objekt: “Rikonstruksioni i objektit nr.2, “godinë 3-katëshe”, në Repartin Ushtarak Nr.1010 Vau-Dejës, Shkodër”, me fond limit 35.605.664,51 leke pa TVSH zhvilluar me datë 27.05.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 1495/9 prot., datë 24.07.2025, protokolluar me tonën nr. 1568/8 prot, datë 25.07.2025, autoriteti kontraktor *Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A.*, lidhur me zbatimin e Vendimit Nr. 917/2025, datë 16.07.2025, njofton se ka zbatuar vendimin e sipërpërmendur, duke e kualifikuar ofertën e operatorit ekonomik “NIKA” ShPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me numër reference Nr. REF-47417-05-09-2025, me objekt: “Rikonstruksioni i objektit nr.2, “godinë 3-katëshe”, në Repartin Ushtarak Nr.1010 Vau-Dejës, Shkodër”, me fond limit 35.605.664,51 leke pa TVSH zhvilluar me datë 27.05.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A.

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe verifikimeve të bëra në systemin e prokurimeve elektronike (SPE) konstatohet se autoriteti kontraktor ka rivlerësuar procedurën e prokurimit, duke kualifikuar ofertën e operatorit ekonomik “NIKA” ShPK në procedurën e mësipërme të prokurimit sipas përcaktimeve të Vendimit K.P.P Nr. 917/2025, datë 16.07.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur”, me numër reference Nr. REF-47417-05-09-2025, me objekt: “Rikonstruksioni i objektit nr.2, “godinë 3-katëshe”, në Repartin Ushtarak Nr.1010 Vau-Dejës, Shkodër”, me fond limit 35.605.664,51 leke pa TVSH zhvilluar me datë 27.05.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

